

Janar - Qershor 2017

Botim i Qendrës, Agjencia AJMMI (Agjencia Joniane e Mjedisit, Medias dhe Informacionit) Nr. 17



Portret i vogelushes rome ne Vrion_(Finiq) (FOTO: SH.H-AJMMI)



BASHKIMI EVROPIAN
DELEGACIONI NE SHQIPERI

ACHIEVE
shoqëria civile shqiptare për një mjedis evropian

REC
Shqipëri

Botim i numrit te kesaj Reviste realizohet ne kuader te projektit te AJMMI-t: "Sensibilizim mjedisor dhe rehabilitim i gjelber i Ishujve te Ksamilit"; aktivitetet i mbeshetetet nga REC Shqiperi dhe financuar nga BE ne kuader te projektit "Shoqeria civile shqiptare per nje mjedis evropian" (ACHIEVE)

“Urat e Mjedisit”

është botim periodik i Qendrës “AJMMI” (Agjencia Joniane e Mjedisit, Medias dhe Informacionit). Në këtë revistë do të gjeni informacione dhe opinione mbi problematikat mjedisore kryesisht në jug të Shqipërisë si dhe çështje të lidhura me zhvillimin e mediave dhe trajnimin e gazetarëve në një rajon multikrahinor e multietnik.

është organizatë joqeveritare, AJMMI jofitimprurëse e jopolitike, e përbërë nga specialistë me përvojë të mjedisit dhe medias që operon në fushat respektive të mjedisit dhe medias, përgjithësisht në rajonin Jonian, në jugun e Shqipërisë e me gjerë. Agjencia “AJMMI” është krijuar në vitin 2007.

VISIONI i Agjencisë “AJMMI: “Miqësor ndaj Mjedisit dhe një Media me fytyrë publike”

STAFI BOTUES

EDITOR: Shkëlqim HAJNO

REDAKSIA:

Kryeredaktor: Dr Agim NELAJ
Panajot BOLI, Blerim KORE
Aferdita SELIMAJ, Sofokli MEKSHI,
Xhorxhi VASILI

KONSULENTË:

Për mediat:
Fatos BAXHAKU - Publiçist
Për mjedisin:
Ing. Kristo KAURI

ADRESA:

Agjencia “AJMMI”/Rr.”A.Çuni”,
Nr.35.L.Nr.4, Sarandë/
Tel/fax: 0852 25678 / 06922 35 026/
0692708020 / 0683031436
agency_ajmmi@yahoo.com
/ www.ajmmi.com

NR. I LLOGARISE

SOCIETE GENERALE ALBANIA
0001177415

IBAN:

AL 9221363010000000001177415

Qendra AJMMI OJF

Shtypur në shtypshkronjën “Argiro”,
Gjirokastër / Art Desing: **Alda Muho**

NGA BRENDIA

PROJEKSION__Bletët dhe cannabis...

Unë kam qenë i hipnotizuar nga këto pyetje! A do të prodhojnë bletët mjaltë psikoaktive? Inerensimi dhe pyetjet më nxitën, për të përcaktuar nëse bletët janë të interesuara për kanabis...

4

Nga Dr. Agim NELAJ




EDITORIAL:

Në pritje të Godosë, apo të zbatimit të ligjit...

Shqipëria, ka qenë dhe, nuk e di për sa kohe, do të vazhdojë të jetë vendi, ku realiteti ia kalon edhe fantazisë! Edhe në sjelljen dhe politikën për një mjedis të qëndrueshëm...

3

Nga Shkëlqim HAJNO



FOKUS: Duam dritë, por jo ‘dritë’ të na verbojë jetën.

Detyrimi nuk mbaron me dhënien e lejës mjedisore. Vertet kemi nevojë për dritë e të ardhura, por jo ‘dritë’ të na shkatërrojë jetën..

5

Nga Panajot BOLI



FOKUS: Sfida mjedisore: Ringjallje e qytetit

Natyrë nuk mund të meret peng. Me natyrën nuk mund të sillemi si padron, ajo nuk pushtohet por me të, bëhen marrëveshje dhe jetohe në harmoni.

6

Nga Kristo KAURI



EVENTE - MJEDIS:

Rehabilitim i shujve jonianë në një dokumentar.

Ne të shkuaren komuniste, vizitat dhe pushimi në këta ishuj, ishte privilegj i hierarkisë të lartë të partise- shtet. Vetem pas viteve 90 këto mjedisë iu kthyen qytetareve vendas e të huaj.

13

Nga Etleva XHAJANKA-ATSH



SOCIALE:

Integrimi i personave me aftësi të kufizuara

Fillimi i zbatimit të ligjit vazhdon dhe mbetet të jetë flamuri i betejave për një qeverisje sa më dinjitoze

Nga Mimoza LLAVDANITI

8



MEMORIE: Jota Ikonomu, spikerja greke e Radio Tiranës

Kane kaluar gati 40 vjet që atehere, por “Sas millun ta Tirana, me jehojne veshet e mi” (Ju flet Tirana)

Nga Petro MEJDI

10



FOKUS: Ndotja e Drinos, impakti në mjedis dhe shëndetin e banorëve

Ndërtimi i një landfilli për depozitimin dhe përpunimin e mbetjeve urbane do të zvogëlonte ndotjen e lumit, Në këtë drejtim edhe zbatimi i një projekti për rehabilitimin e rrjetit të kanalizimeve të ujrave të zeza të qytetit do të shmangte ndotjen mjedisore të Drinos.

9

Nga Blerim KORE



“Në pritje të Godosë” apo të zbatimit të ligjit..-

- Mjedisi i qëndrueshëm ..., pas listës ! -



Nga Shkëlqim HAJNO

Gjatë një takimi me gazetarët e jugut, në prag të zgjedhjeve të përgjithshme të 25 qershorit (2017) në Shqipëri, një prej drejtuesve kryesor të PD, (më saktë Sekretari I Përgjithshëm I saj) pyetjes se përse në asnjë takim me publikun kjo force politike nuk ka artikulluar asnjë togfjalësh për politikën e saj për mjedisin e qëndrueshëm, kur vetëm në JP të Shqipërisë, ka problematika të mprehta ; u përgjigj sinqerisht se “ janë çështje shumë teknike për publikun, dhe, do të merren specialistët më vonë... ”

Me fjalë të tjera....publiku ... nuk kupton!?

Dhe vijon politika e madhe (!) ne pothuaj të gjitha programet e partive ...në një vend me varfëri të madhe dhe magalomani të madhe ! Përtej batutave në takimet elektorale, a mbeti së paku ndonjë fjalë që do të artikulohej për politikën e zhvillimit të qëndrueshëm nga liderët politikë të mazhorancës dhe opozitës gjatë fushatës së fundit për zgjedhjet elektorale të 25 qershorit? Dhe më tej, cila ishte optika në rajonin jugut të Shqipërisë për këtë adresim në krye të këtyre shenimeve?

Me ndonjë përjashtim, në takimet elektorale të qarkut Gjirokastrë, në atë të Vlorës, pak ose aspak. Nga ana tjetër, edhe në prioritetet e 11

bashkive të Jugut, nëse do të ndaleshim ne problematikat mjedisore ; do të mësonim se ne projektet e ndermarra “lahet goja” me detyrimin ligjor për dëgjuesat publike me komunitetet.

Shpesh, kinse dëgjuesat, janë ca takime të hibridizuara të llojit si ato “dëgjuesat “ hipotetike për HEC-et që po pushtojnë lumenjtë anekënd vendit, nga Valbona, në Parkun Shebenik-Jabllanicë, e më poshtë në Vjosë, ku projektet malinje e kanë mbërthyer mjedisin ujqor të lumenjve si në Langaricë e më poshtë në Vjosë, kercasin dhëmbët si kanionet e Nivicës, Lekdushit, Progonatit, etj..

Telegrafikisht: Në bregdetin e Gjirit të Sarandës sipas eksperteve të mjedisit, janë shndërruar në sipërfaqe toke// plazhe private// rreth 70.000 m2 det....!?

Pluhuri 24 orësh i dy guroreve //me leje//në nisje të rrugë turistike Sarandë-Himarë-Llogora; u ka zënë sytë specialisteve të Ministrisë së Mjedisit në 20 vitet e fundit; pa zënë në gojë rrogëtarët fundorë që paguhet veç të tjerash edhe si roje të mjedisit të territorit ku kryejnë funksionet dhe jo të planetit Mars...

Më tej akoma , gurore të paligjshme ende shfrytëzohen nga menaxhere kinse “anonimë” , sot e gjithë ditën në bregdetin e Sarandës në vendin e quajtur Berdenesh pa u trembur nga askush....etj, etj.

Të shpresojmë për qasje të re mjedisore dhe serioze . Së paku me draftin e ri të qeverisjes për të cilin flet së fundi edhe kryeministri Rama, kur përmend së kanë nisur turret e degjesave për punën e zyrave të administratës shtetërore.

Kreu i qeverisë thotë se “Pas këtij turi 30 ditor, të gjitha të dhënat e mbledhura për institucionet dhe zyrat e shtetit, do të analizohen imtësisht qark për qark. Mbi bazën e tyre do të përgatitet një raport ku do pasqyrohet cilësia e punës, niveli i shërbimit dhe reputacionit publik të çdo dege të administratës shtetërore e të çdo drejtuesi përkatës” .

Te shpresojmë.

..Kam bindjen se Shqipëria, ka qenë dhe, nuk e di për sa kohe, do të vazhdojë të jetë vendi, **ku realiteti ia kalon edhe fantazisë!** Edhe në sjelljen dhe politikën për një mjedis të qëndrueshëm.

Ndaj , ende më ka mbetur në mendje një frazë nga romani “ **secili çmendet sipas mënyrës së vet**” që, rezonon me realitetin e përditpërballjes: “... ngadonjëherë të duket se njeriu, buballa, maskara dhe I pabesë, siç është, vazhdon t'i shpallë luftë natyrës me bëmat e veta”.

Gjithaq edhe me grykësinë e vet të lamaksur ... Në një vend normal nuk duhet te kete shumë vend për të pritur pafundësisht .Por për veprim . Ca më keq, si në pjesën e famshme te Beketit “**Në pritje të Godosë**” ///





Nga Dr. Agim Nelaj

Ka mjaft diskutime dhe debate shkencore për marrëdhëniet e bletëve me bimën cannabis. Një studiues thotë se:

Kur u kam thënë njerëzve se bletët kanë akses në cannabis, reagimi ka qenë gjithmonë e njëjtë; pyetën nëse bletët janë (dehur) dhe nëse mjalti i tyre do ti bëj njerëzit (edhe të dehur).

Unë kam qenë i hipnotizuar nga këto pyetje! A do të prodhojnë bletët mjaltë psikoaktive? Ineresimi dhe pyetjet më nxitën, për të përcaktuar nëse bletët janë të interesuara për cannabis, çfarë mund të grumbullojnë pak nga pak nga cannabis, si dhe efekti mbi bletët i produkteve të tyre... Kam pasur një mundësi për të kontrolluar zgjojtë, të paktën një herë në javë, duke shpresuar për disa vëzhgime. Kryesisht nëse bletët janë në punë për grumbullim nektari ose poleni. Unë u zhgënjëva.

Pse? Hipoteza se bletët nuk tërhiqen nga aroma e bimëve të cannabisit, ishte e dyshimtë. Bletët kanë një sens të hollë nuhatje. Ato përdorin atë, për të zbuluar feromonet e bletët e tjera dhe për të gjetur nektar. Gjithashtu e tërheqin edhe ngjyrat. Të dy këto janë për shqisat si tabela neoni për gjetjen e ushqimit. Cannabis nuk i ka këto attribute. Pra, ka arsye që bletët nuk do ta gjejnë cannabisin, si bimë tërheqëse... Gjithësesi ekziston mungesa e informacionit specifik, për të sugjeruar tërheqjen e cannabisit ((bletëve) në literaturë.

Ndonëse një pjesë e pamjeve filmike, të shfaqura në mediat sociale në dukje ishin kontradiktore. Pamjet filmike tregojnë bletët duke gumëzhitur mbi një bimë cannabis. Ato u shfaqën duke kërkuar ushqim (Nicolas, 2015). Shikuesit duke parë pamjet, besojnë se bletët shfaqin disa eksitime kimike nga kontakti i tyre

Bleta dhe cannabis (Cannabis)

me bimën. Ndonëse kjo është shumë e vështirë. Bleta nuk ka neuroreceptorë që do ta lejojnë atë, për të kapur elemente psikoaktive të pranishëm në bimë Studiuesit: McPartland, J. DiMarzo, V. De Petrocellis, L. Mercer, A. qelqi, M), zbuluan se insektet nuk prodhojnë acid arachidonic. Ai është një pararendës i nevojshme. Mendohet se CB (cannabinoid) receptor, ka humbur në insekte gjatë rrjedhës së evolucionit. Autorët gjithashtu kanë vënë në dukje se receptor CB, duket se është i vetmi neuroreceptor që njihet. Ai është i pranishëm në gjitarët dhe mungon në insektet. Për shkak të mungesës së tij të dokumentuar, në mënyrë të besueshme mund të themi se bletët janë në gjendje të përjetojnë cannabis në të njëjtën mënyrë si njerëzit. Secili nga ne natyrshëm shtron pyetjen; nëse mjalti i prodhuar nga bletët që kanë qasje në bimë cannabis përmban THC. Dhe nëse ajo ushtron një efekt psikoaktive mbi ata që e konsumojnë?

Pyetje që nuk kanë përgjigje përfundimtare. Kërkimet vazhdojnë. Studiues të tjerë sqarojnë se: bima nuk prodhon ndonjë aromë që të jetë tërheqëse për bletët. E rëndësishme është që bima nuk është në gjendje të ofrojë një shpërblim në formën e nektarit të luleve. Bima mashkull në disa rrethana nuk ofron polen. Cannabis Artikulli shkencor për cannabis (Dallo, J.S., 2012) vë në dukje se tek kjo bimë, poleni duhet të jetë ushqimi i fundit për bletët. Autori vëren se bletët (në Indi, ku kanë ndodhur vëzhgimet) gjejnë burim proteine në bimën cannabis. Bleta siguron këtë lëndë në bimët meshkuj, gjatë kohës kur organet riprodhuese të cannabisit mashkull lëshojnë polen. Bletët janë të interesuara vetëm për atë polen, në mungesë të tij në natyrë. Duke kërkuar përgjigje për disa pikëpyetje, Norman Carreck (Drejtor Shkencës dhe drejtor i lartë i revistës / Kërkime në Bletari/) i cili sugjeroi se burimi i mundshëm i atraktivitetit të cannabis femër për bletët, mund të jetë "nektari jashtë lules". Nektari shtese i lules buron nga gjëndrat që ndodhen jashtë luleve prodhuese (lëngë i embël). Në bimë të cannabisit, trichomes bulbor, janë disa lloje. Kjo e fundit

përmban shumicën e cannabinoidëve psikoaktive (THC, THCV, CBN). Duket se trichomes kanë evoluar me qëllim që ta bëjnë këtë bimë, pak më të shijshme për kafshët dhe insektet (Anonymous, 2016). Ai hedh idenë se; ka më shumë të ngjarë që bletët të mbledhin rrëshirën (propolis), ujë dhe lëngë të embël në sipërfaqe të gjetheve. (Dr. Caron, 2016).

Gjithësesi, cannabis dhe meslidhja me bletët, duket se në disa aspekte të marrëdhënies ndërmjet bletët dhe cannabis nuk janë verifikuar ende. Duke gjykuar nga deklaratat që jepen në diskursin publik, ka dezinformata rreth këtyre marrëdhënies. Tashmë është vërtetuar se; edhe në qoftë se mjalti rezulton me alkaloidë të tilla, produktet e bletës nuk mund të kenë efekte psikoaktive pa ngrohje. Kjo lidhet me konvertimin alkaloidë që nga gjendje pasive të kthehet në një gjendje aktive (decarboxylation). Kështu personat që raportojnë se, pasi ka në ngrënë mjaltë direkt nga bletët, që kanë qasje në cannabis, ka më shumë gjasa të flasim për një fenomen psikologjik, sesa një fiziologjik.

Gjithësesi vëzhgimet e ardhshme, ka të ngjarë të japin më shumë informacion në meslidhjen cannabis-Apis mellifera. Për aq sa dihet, ende nuk ka shqyrtime të përmbajtjes së zorrëve të bletëve, për vërtetuar dyshimete mësipërme.



Duam dritë, por jo 'dritë' të na verbojë jetën

-Prioriteti: Mjedisi, jeta e njeriut jo vetëm xhepi-



Nga Panajot BOLI

Dyndja e viteve të fundit drejt lumenjve, (pasi i gerryen dhe i mbaruan me inertet) ,për të ndertuar hidrocentrale, ka krijuar probleme serioze me mjedisin si për faunen, ashtu edhe për florën. Dhe gjithë kjo dyndje synon për njerën anë të medaljes: përfitime të leverdishme ekonomike. Këtu nuk do të analizojmë si i marrin lejet mjedisore nga dora 'ë ngrohtë' dhe 'zemërgjerësi' e Ministrisë së Mjedisit. Ky është një kapitull tjetër. Problemin që duam të ngrejmë është, sa i plotësojnë dhe i respektojnë ato detyrime që kanë subjektet të përcaktuar në lejen mjedisore. Ndofta jam i gabuar, por kam verejtur se as edhe nje detyrim me të thjesht, siç është ajo e rikuperimit të mjedisit që kanë zhveshur, nuk bëjnë, pa le të tjerat. Le të ndalemi te një shembull konkret: te hidrocentrali privat, në krah të majtë të Hidrocentralit 1 të Bistricës. Kushdo që kalon në aksin rrugor Sarandë-Gjirokastër, do t'i bie në sy pamja jo e kendshme e krijuar pas ndertimit të këtij hidrocentrali privat. Mes bimesisë së dendut të gjelbërt të Sirakatit dallohet 'plaga' e madhe e gërmimit. Këtu fillon prezantimi i keq. "Problemi- thotë specialisti i mirënjohur i Pyjeve dhe Mjedisit Kristo Kauri- nuk është thjesht marrja e lejes mjedisore nga Ministria e Mjedisit, por procedurat, rregullat, detyrimet që kerkohen te ndiqen , të zbatohen dhe të respektohen në realizimin e veprës nga çdo subjekt. Kam përshtypjen, dhe

keshtu është, se asnjë nga këto detyrime mjedisore nuk respektohen e nuk zbatohen. Thjesht për ta prioritet ka vetëm përfitimi sa më i lart ekonomik, në djall le të vejë mjedisi. " Dhe specialisti sqaron: 300metra kub dhe ka ikur nga pllaja dhe përfundoi në lumë (merrni me mend edhe demtimet në gjallësat),asnjë rikuperim të mjedisit të gjelbert që u shkatërrua, d.m.th. prishjen e gjithë ikosistemit.se ajo është zinxhir, nga ndryshimi i rrjedhjes se ujit, ndikimi të gjallësat, te mjedisit ..e tjera..pra është zinxhir, dhe po u prish njera, demtime ka në gjithë këtë zinxhir Pra , siç e shikoni, mjedisi e paguan. Dhe pas mjedisit jeta e njeriut.Pas gjithë kësaj që thamë, asnjë impenjim nga institucionet përgjegjëse.Nuk e shikon këtë policia pyjore e Bashkisë Finiq? A nuk është në kompetencë të saj? Po inpektoriati i Ministrisë së Mjedisit? Vetëm të leshojnë leje janë? Dhe me e domosdoshëm : duhet të këtë bashkërendim dhe bashkëpunim mes tyre. Ka ardhur koha që me lejen mjedisore para , të kontrollohen një për një të gjitha detyrimet që ka një subjekti.

Lidhur me kete problematike kur nje investitor i ben 'qorra' vendimarresit lokale dhe ca me teper komunitetin e banoreve ; specialisti i pyjeve Kristo Kauri shperhet : " Nuk jam

kunder ndertimit te H/C,por jam qe te percaktohen standarte,modele,te studjohen e miratohen zonat e zhvillimit te qendrushem,cdo projekt e ndertim te gjej ekuilibrat midis mbrojtjes se Natyres,Mjedisit dhe zhvillimit.Te investojme per te ardhmen dhe mireqenien tone,por mos te ndryshojme e tjetersojme Natyren dhe vete jeten tone.Vleresimet e Ndikimit ne Mjedis te mos jene qesharake, te papergjegjeshme dhe te plotesojne vetem dëshirat e investitorit, por te jene studime te thelluara dhe te kryera nga specialiste pasionant qe nuk mungojne. Kauri i jep kete koment:" Nuk mund te vendosish fatin e Lugines Valbones,Vjoses,Langarices,Bistrices te krijuara per miliona vjet me nje firme te papergjegjeshem per tri minuta.Perrenjte dhe lumentë e Luginave jane venat e tyre qe i japin jete njeriut,flores,faunes,habitave dhe miliarda organizmave qe ndodhen ne lugine. Keto ndertime te pastudjuara sjellin pasoja te pariparrushem ne prishjen e ekuilibrave,humbje me qindra specie,habitave,humbje peisazhi dhe cvendosje te popullsisë."

Detyrimi nuk mbaron me dhënien e lejes mjedisore. Vertet kemi nevojë për dritë e të ardhura, por jo 'dritë' të na shkatërrojë jetën.///



Sfida mjedisore: Ringjallje e qytetit



Nga Kristo KAURI

Saranda. Një qytet ku Zoti ka qenë shumë bujar me bukuritë që i fali, me detin, gjirin, malin, diellin, gjelbërimin.. Zoti na i dhuroi, por ne nuk dijtëm t'i vlerësojmë, t'i cmojmë, t'i ruajmë dhe t'i shtojmë. E kishim me të bukur Saranden tone, e kishim me te gjelberuar. P oezia qe ofronte Natyra ishte me magjepsese, hyrja e saj ishte një himn madhështor. Gjate këtyre 25-viteve Saranda u zmadhua, u zgjerua dhe u trefishua. Krahas ndërtimeve të bukura, harmonike, mbresëlënëse qe jane si oaze, e pergjithshmjia është kaotike. Nga cdo kendvështrim, nga ajri, deti, mali, apo nga brendësia e saj, të bie në sy zhvillimi kaotik urban, tjetërsimi i natyrës, mjedisit, peizazheve dhe standartet e ulta arkitekturore. Pallatet dhe ndërtimet i marrin frymen njeri tjetrit, pa hapësirë, me rrugë dhe trotuare tepër të ngushta dhe me mundësi shumë të pakta për shtimin e sipërfaqeve të gjelbra. Qyteti ky organizem i gjallë me pallate, njerëz, biznese, makina, dyqane, ku punojnë dhe jetojnë në një mjedis të perbashkët, vështiresohet në frymëmarrje, në qarkullim. Filtrat e qytetit bllokohen, pallatet dhe asfalti i përcjellin energji negative njeri-tjetrit dhe qytetarëve që jetojnë u bet jeta e vështirë. Ata që janë pergjigjës për këtë gjendje jetojnë në vila të ndërtuara në vendet më të bukura dhe të qeta. Disa kanë ikur më vrap në Tiranë apo jashtë vendit për të mos u kthyer më kurrë në këtë qytet. Bile disa krenohen për bëmat e tyre dhe jetojnë krejt të qetë. Zhdukja pa kritet i makjes mesdhetare, gjelbërimit dhe zëvendësimi i saj me cemento dhe hekur; janë krime mjedisore që nuk janë ndëshkuar, krime qe i vuajmë ne sot dhe brezat që do të vijnë. Megjithë këto probleme, prapë Saranda jonë e dashur

mbetet e bukur, admiruese, tërheqëse dhe vizitohet nga mijëra turistë të vendit dhe të huaj. Që të mbetet një destinacion turistik, duhet të jetojmë në harmoni me natyrën. Po e ndjejmë në kurriz që bukuria e natyrës nuk është e perjetshme. Është domosdoshmëri të mbrojmë atë që mbeti krejt rastësisht. Të të mos ripërsëriten të njëjtat gabime, duhet të ruhen raportet e territorit det-gjelbërim-sytet me një menaxhim të qëndrueshëm. Kur ekziston dashuria për qytetin ekziston dhe shpresa dhe kjo është krejt e realizueshme. Investimet që po bëhen në shetitore dhe zgjerimin e sipërfaqeve të gjelbra, janë domethënëse dhe shpresdhënëse. Kurora e pishave megjithëse e zvogëluar gjatë viteve nga presioni i ndërtimeve, ku mbeti vetëm 1/3 e saj, sot ofron vlera të mëdha natyrore, shëndetësore, turistike, peizazhi... Me miliarda gojëza që ndodhen poshtë gjetheve dhe halave na clirojnë O₂ dhe thithin CO₂. Ajo krijon një klimë të freskët ditë e nxehta të verës, që në qytetin tonë zgjat mbi katër muaj, dhe ngrohtësi në dimër, krijon një atmosferë të gëzuar dhe dëshire për jetën. Kurora dhe drurët janë kondicionerë gjigantë natyror. Kur temperatura në qytet është 40 gradë celsius dhe në asfalt mbi 70 g.c., poshtë pëmës nuk i kalon 25 gradë. Është kjo arsyeja që në verë vrapojmë nën hijen e pemëve për të shmangur diellin përvelonjës. Temperaturat e larta përbejnë rrezik serioz për njerëzit dhe valet e nxehta janë shkaktarë për shumë vdekje në qytetin tonë. Kurora dhe gjelberimi që mbeti të heqin mërzitjen, stresin, melankolinë. Në një mjedis të shëndoshë, jetojnë dhe banojnë njerëz të shëndoshë, në një mjedis të sëmurë, plot mikrobe dhe pluhur, të shkretuar dhe cimentuar, jetojnë njerëz të sëmurë. Një

njeri merr frymë 9,5 ton ajër në vit dhe oksigjeni përbën vetëm 23 % të kësaj sasive. Për prodhimin e kësaj sasive duhen të paktën 7-8 drurë të rritur për banorë.

Ekzistenca e dy gurorëve në afërsi të qytetit, shtimi i makinave sidomos atyre me naftë, kondicionerët elektrik. etj ., kërcënojnë seriozisht qytetarët. Kurora, drurët, shkurret janë mushkuritë e qytetit, pastrojnë ajrin, e freskojnë atë, bejnë hije mbi tokë... Një sipërfaqe kurorë e pishave të qytetit tonë prej 1-ha. thith rreth 800-1200 ton CO₂ në vit. Fitoncidet e pishes, blirit, panjes, eukaliptit ..që ndodhen në qytetin tonë shkatërrojnë bakteriet që janë me miliarda për cdo CM³ ,duke i vrarë ato për 5-6 minuta plotësisht. Kurora e qytetit ofron strehim për shumë habitate shpendësh dhe kafshësh, mikroorganizmave të dobishme, ndalon erozionin, vërshimet e ujrave, fenomen ky shqetësues për këtë qendër urbane. Na mbron nga erërat, zhurmat, ofron peizazhe të bukura dhe nxisin turistët e natyrës që ta vizitojnë. Këtë kurorë që mbeti, duhet ta mbrojmë të gjithë. Kemi nevojë për një ringjallje shpirtërore të qytetarëve, institucioneve ligjore... Dashuria dhe kujdesi duhet të dalin jashtë mureve të shtëpisë, të përfshijë gjithë pjesën dhe shtrirjen e qytetit, mjediset publike dhe private. Natyra nuk mund të meret peng . Me natyrën nuk mund të sillemi si padron, ajo nuk pushtohet por me të, bëhen marrëveshje dhe jetohe në harmoni. Janë këto pisha, palma, panja, bliret, bananet, bunkëvilet, jargavani, manjola, eukaliptet, xhixhibanozi që mbulojnë sadopak cementon e frikshme dhe japin shpresë dhe na bëjnë ta duam më shumë këtë qytet. ///



TACSO Albania, forcon kapacitetet e shoq. civile mjedisore

Gjat muajit prill si edhe ne fillim te muajit qershor, TACSO Albania, organizoi seminare trajnuese per organizata t e Shoqerise Civile ne Shqiperi. Prej dates 12 deri me 14 prill 2017, ne Tushemisht Pogradec Tacso-Albania (Asistenca teknike per organizatat e Shoqerise civile me qender ne Tirane.) zhvilloi nje seminar trajnus me perfaqesues nga te gjitha organizatat e shoqerise civile qe ushtojne veprimtarine e tyre ne vendin tone. Me shume se 30 pjesemrrjes iu nenshtruan trajimit me teme Aftesimi i OJF-ve per advokatine midis tyre dhe aftesimin per aplikime ne fushen e mjedisit te qendrueshem ne shqiperi.. Trajnimi i dyte i zhvilluar me 7 dei 9 qershor 2017, me teme Zhvillimi Organizativ he planifikimi strategjik i rrjeteve te shoqerise civile ne Shqiperi. Trajnieri i ketyre seminareve ishte zoti Genci Pasko, drejtor i TACSO - Albania.. Ne perfundim te ketyre dy trajnimeve, per pjesemarresit u shperndane Certifikate personale. TACSO ka nje programe te zgjeruar per aftesimin dhe rritjen e kapaciteteve te OJF te Shoqerise Civile, te cilat do te kryhen ne muajt qe vijne.

Sofokli Mekshi

koordinator, AJMMI



Bashkëpunim shqiptaro-grek për mbrojtien e pyjeve nga zjarret

Shërbimi zjarrfikës në Gjirokastrë po synon intensifikimin e bashkëpunimit me zjarrfikësit e Janinës për parandalimin dhe shuarjen në kohë të zjarreve në sipërfaqet pyjore përgjatë zonës kufitare. Së fundi zjarrfikësit e Gjirokastrës dhe rajonit të Epirit (Greqi), zhvilluan një stërvitje të përbashkët në zonën kufitare të Koshovicës (Shqipëri) dhe Kastanjas (Greqi). Në stërvitjen dy palëshe u përfshinë 27 efektiva si dhe 9 automjete. Sipas drejtuesit të Shërbimit Zjarrfikës të Gjirokastrës, Kujtim Bizhga, është hartuar një plan bashkëpunimi midis zjarrfikësve shqiptarë dhe grekë për zjarret e verës. “Krahas ndërhyrjes në terren ky plan bashkëpunimi synon edhe shkëmbimin e informacionit në rastet e zjarreve apo emergjencave civile në të dyja anët e kufirit.”, u shpreh Bizhga. “Qëllimi i shërbimit zjarrfikës të Greqisë është që të ndihmojë njerëzit pa dallime etnie, race apo feje dhe besoj se ky është është edhe synimi i zjarrfikësve të Shqipërisë. Duke u mbështetur mbi këtë parim të dyja shërbimet zjarrfikës do të bashkëpunojnë ngushtësisht gjatë periudhës së verës duke ndërhyrë në rastet e vatrave të zjarreve si dhe për të minimizuar dëmet e tyre”, pohon drejtuesi i zjarrfikësve të rajonit të Epirit, Kostandinos Skupras. Ndërsa ka ndjekur nga afër stërvitjen e zhvilluar, konsulli i Shqipërisë në Janinë Pervin Gjukuria, u shpreh se “bashkëpunime të tilla duke përfshirë edhe ndihmën për emergjencat civile të verës synojnë tu vijnë në ndihme banorëve në të dyja anët e kufirit kryesisht në raste e zjareve problematike”. “Greqia dhe Shqipëria gjeografikisht janë shumë afër po kështu kemi një bashkëpunim shumë të mirë mes dy shteteve dhe popujve tanë. Mendoj se kjo afërsi gjeografike dhe ky mirëkuptim mes dy popujve tanë do të na ndihmojë për të qenë efikas për shuarjen e zjarreve të verës në zonën kufitare midis dy vendeve”, u shpreh konsulli i Greqisë në Gjirokastrë, Vasilios Tolios.

B. Kore

Integrimi i personave me aftësi të kufizuar.



Nga Mimoza LLAVDANITI

GJIROKASTER. Personat me aftësi të kufizuar kohët e fundit kanë ngritur fuqimisht zërin për nevojat e tyre sa të domosdoshme dhe jetike ,po aq dhe prezente .Shpesh ta papërfaqësua dhe të pa informuar janë gjendur në mes të situatave jo të këndshme, ku të drejtat e tyre janë nëpërkëmbur.Të përfaqësuar në nivel kombëtar dhe local ata janë një zë I fuqishëm për të mbrojtur dhe kërkuar çdo të drejtë legjitime që ju takon .Janë kategoria që sot jo vetëm si nivel përfaqësimi, por dhe si vendimarrje, duhet të jenë pjesa e integruar e zhvillimit të shoqërisë së emancipuar . Angazhimi I personave me aftësi të kufizuar përmirëson proceset demokratike rigjeneron ide dhe krijon një atmosferë motivimi e cila rezulton në ngritjen e standarteve të jetesës. Secili prej këtyre individëve I ndërgjegjshëm për rolin e tij, kërkon ndryshime që bëjnë të mundur adaptimin në shoqëri. Elemente që në pamje duken kaq shumë të thjeshta për njerëzit normal, e kundërta ndodh për personat me aftësi të kufizuar; gjërat kaq shumë të thjeshta, shëndërrohen në vlera të shenja . E gjendur në situata dhe realitete kaq të ndjeshme përballë fakteve që rrethojnë shoqërinë tone , ne jemi bërë si shoqëri më të ndjeshëm dhe më realist. Kjo, pasqyrohet në bashkëpunimin që pushteti lokal dhe ai qëndror po ben

dhe e ka përqëndruar vëmëndjen në nevojat primare që ka kjo shtresë. Bashkia e Gjirokastrës ndërmjet objektiva dhe angazhimeve të tjera në fushën e ndërtimit dhe zhvillimit, duke e konsideruar këtë kategori pjesë e domosdoshme e shoqërisë, ka treguar kohët e fundit vëmëndjen maksimale për të siguruar akses dhe lehtësi në të gjitha institucionet e qarkut dhe hapësirat publike .Me ndihmen e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim (OSCE) dhe nën mbështetjen e kryetares së bashkisë Zamira Rami, së fundmi u paraqit dhe një platformë mbështetje për gjithë personat me aftësi të kufizuar. Po kështu, kryetarja e shoqatës së personave me aftësi të kufizuar Vjollca Koko, e gjendur shpesh në pozita jo favorizuese për t'i ardhur në ndihmë ketij kontigjenti, duke qënë se mbart po të njëjtat probleme shëndetësore ,e ardhur pikërisht nga fusha e shëndetësisë; po trajton problemet dhe ofron ide e bashkëpunim serioz që këta persona, të mos ndihen të nënverësuar. Të ndihmosh të tjerët duhet të jetë një shtysë natyrale në një shoqëri moderne dhe civile. Kjo qasje është thelbi I mirënjohjes ndaj vetes dhe ndaj individëve me probleme shëndetësore .Vetëm kohët e fundit në të gjitha akset rrugore është punuar për funksionimin e rampave që krijojnë mundësinë e ecjes së lejueshme jo vetëm për këmbësorët por dhe për një pjesë të madhe të cilët përdorin karrocet për lëvizje . Po punohet me këmbëngulje për ngritjen e qëndrave të rehabilitimit ,si një alternativë për të zhvilluar aftësitë e tyre .Shumë prej personave me aftësi të kufizuar,I përkasin fushave të ndryshme të arsimimit çka bën te ndjeshme nevojën e tyre të përfaqësimit , në vendimarrjen dhe zbatimin e ligjshmërisë në dobi të ketij komuniteti. Demokracia përcaktohet nga disa parime dhe praktika

themelore që përmbushin një shoqëri .Një ndër parimet kryesore është e njerëzit janë të gjithë të barabartë dhe kanë të drejta të caktuara individuale . Një demokraci ekziston kur qytetarët janë të aftë të marrin pjesë në mënyrë aktive në jetën e shoqërisë së tyre duke ushtruar të drejtat e tyre individuale , si lirine e fjalës dhe mendimit . Natyrisht ,kohezionin shoqërisë mund t'ja sigurojnë vetëm nëpërmjet pjesëmarrjes në të drejta dhe vendime .Raporti i individit me shtetin ,idealisht mund të jetë i tillë ,që të prodhojë qytetari nga njëra anë ,dhe legjitimitet nga ana tjetër. Por nëse zëri i tyre nuk dëgjohe dhe nese nuk zbatohet ligji, problemet do të jenë shumëfish dhe më të mëdha. E nisur nga këto kërkesa ndër vite ,shoqata e personave me aftësi të kufizuar,në Bashkinë e Gjirokastrës ka sot një mbështetje dhe partnere të fuqishme në të drejtat e tyre. Sigurisht që fillimi I zbatimit të ligjit vazhdon dhe mbetet të jetë flamuri i betejave për një qeverisje sa më dinjitoze në dobi të qytetarëve,sepse këta qytetarë janë ata që sot më shumë se kurrë kanë nevojë për vëmëndjen e gjithë shoqërisë sonë. Kjo klimë e pushtetit vendor ndaj kësaj kategorie vendos ura bashkëpunimi për më shumë marrëdhënie në të drejtat e tyre legjitime. T'ju ndodhesh pranë është një shtysë natyrale në një shoqëri moderne dhe civile ,çka evidenton se emancipimi i shoqërisë dhe ligjshmërisë janë domosdoshmërisht ekuacion devotshmërie.Përball fakteve të tilla në tipologjinë institucionale duhet të mirëmenaxhohen burimet njerëzore të cilat ofrojnë cilësi shërbimi .Zëri i së drejtës institucionale është padyshim ajo që presin sot kjo kategori personash.Tashmë sfida të rëndësishme dhe e drejta ligjore për mbështetje, janë padyshim një nga pikat kyçe, që këta persona presin në vazhdimësi per t'u ndjere sa me mire dhe me dinjitet njerezor ne jeten shoqerore.///



Nga Blerim KORE

Depozitimi pa kriter i mbetjeve të ndryshme përgjatë shtratin të lumit Drinos po dëmton jo vetëm mjedisin por po kthehet në një rrezik edhe për shëndetin e banorëve në Gjirokastrë. Alarmi për këtë situatë vjen nga banorët si dhe specialistët e mjedisit dhe shëndetsisë. Agron Nini, prej 10 vitesh peshkon në ujrat e lumit, në zonën në hyrje të qytetit të Gjirokastrës. “Në këtë pjesë të lumit ka gjithfarëloj mbetjesh duke nisur me ato urbane, gomat e makinave, etj të cilat ndotin jo vetëm mjedisin por po çojnë drejt zhdukjes edhe gjallesat që rriten në lumë. Peshku vjen duke u pakësuar çka bën që të qëndroj me orë të tëra për të zënë diçka”, thotë Agroni.

Por ndotja e ujrave të Drinos po kthehet edhe në problematikë për shëndetin e popullatës. “Çdombasdite përshkoj me këmbës rrugën në dalje të qyteti të Gjirokastrës, anës lumit Drino. Me rritjen e temperaturave të stinës nga rrjedha e tij vjen era e rëndë e ndotjes si shkak i derdhjes së kanalizimeve të ujrave të zeza. Në ditët në vazhdim do ta kem të pamundur ecjen pasditeve në këtë zonë të qytetit”, thotë i moshuari Ajet Kola. Me shqetësim për këtë situatë shprehen edhe përfaqësuesit e institucioneve të mjedisit në Gjirokastrë. Sipas drejtorit

Ndotja e Drinos, impakti ne mjedis dhe rreziku për banorët

të Agjensisë për Mbrojtien e Mjedisit, Stefan Rapi, depozitimi i ujrave të zeza në shtratin e lumit Drino po ndot jo vetëm mjedisin por po e kthen këtë lumë në rrezik për shëndetin e popullatës. “Nga monitorimet mjedisore kanë rezultuar parametra të lartë të ndotjes kryesisht në zonën e lumit që përshkon qytetin e Gjirokastrës. Në këtë segment të shtratin të Drinos përfundojnë pjesa më e madhe e rrjetit të kanalizimeve të ujrave të zeza të qytetit duke sjellë jo vetëm ndotjen e mjedisit por edhe probleme për shëndetin e popullatës. Nga monitorimet e vazhdueshme që ne i kemi bërë rrjedhës së Drinos rezulton fakti se si shkak i pranisë së ujrave të zeza ndotja e lumit është disa herë më e madhe se parametrat e lejuara”, pohon kryemjedisori Rapi. Në këtë situatë është dëmtuar rëndë flora dhe fauna në rrjedhën e këtij lumi, një prej kryesorëve që përshkon Jugun e vendit. Më shqetësuese bëhet kjo situatë edhe për shëndetin e popullatës. Mjekët infeksionistë shprehen me shqetësim së ujrave të ndotura të lumit, janë burim infeksionesh për banorët që jetojnë përgjatë brigjeve të tij apo që lahen në rrjedhën e lumit. “Ndotja e ujrave të Drinos është një burim problematik për disa sëmundje infektive të lëkurës por edhe sëmundje të tjera të organizmit. Si shkak i sasisë së madhe të ndotjes së ujit po rritet numri i personave që preken prej tyre. Ne i kemi bërë thirrje popullatës që shmangë frekuentimin e lumit qoftë edhe për tu larë gjatë ditëve të nxehta”, thotë mjeku infeksionist Xhelo Brahimi, Drejtuesi i Agjensisë Rajonale për Mbrojtien e Mjedisit,

Stefan Rapi shprehet se “prej fillimit të këtij viti janë ndëshkuar me gjoba disa subjekte si shkak i depozitimit të mbetjeve inerte në shtratin e Drinos. Gjopa të tilla për subjektet e ndryshme apo qytetarët që ndotin Drinon janë aplikuar edhe gjatë viteve të kaluar por sërish depozitimi i mbetjeve në lumë vazhdon të jetë shqetësues. Në vazhdimisht kemi kërkuar nga firmat e ndryshme si dhe banorët që të shmangin depozitimin e mbetjeve të ndryshme në lumin Drino. Ndërtimi i një landfilli për depozitimin dhe përpunimin e mbetjeve urbane do të zvogëlonte ndotjen e lumit, Në këtë drejtim edhe zbatimi i një projekti për rehabilitimin e rrjetit të kanalizimeve të ujrave të zeza të qytetit do të shmangte ndotjen mjedisore të Drinos duke e kthyer këtë lumë në një resurs natyror të veçantë për Gjirokastrën”, shprehet drejtori i



Jota Ikonomu , spikerja greke e Radio Tiranës , - “Sas millun ta Tirana -ja hara”-

Ideja e këtij shkrimi, kishte kohe që jetonte brënda meje !Nxitjen ma dhanë ca shënime të mbajtura pasi lexova një portret në “Gazeta e Athines “, botim i emigrantëve shqiptarë ne Greqi .

Nje gazetar i kësaj gazete, kishte nje ide shume të mire për të takuar ish spikerin , folësen e emisionit greqisht të Radio Tiranës, Jota Ikonomu. Gazetari e gjeti Jotën në Peristeri , në Athine, në një apartament të thjeshtë , të plakur tashmë !Jota kishte lindur në Zmirni , (Izmir) të Azisë së Vogël, në Turqi. Ishte fëmijë , kur zbriti ne vitin 1922 nga vapori i vjetër në Pire. Fëmijë refugjatesh grekë të dëbuar nga trojet e tyre ! Në vitin 1938 ajo njihet me një diplomat shqiptar dhe pasi u martuan, vjen përgjithmonë në Shqipëri \ U thir si folëse në emisionin greqisht të Radio Tiranës , emision , i cili , në vitet 60 -70 -të , degjohej aq shumë si në Shqipëri, nga minoritarët dhe sigurisht, në Greqi , për dëgjuesit e atij vendi, për të cilët dhe transmetohej, për të propaganduar arritjet e Shqipërisë socialiste te kohes në të gjitha fushat.

Më ka rastisur të njoh shumë grekë , te cilet , vite më parë degjonin Radio Tiranën . Dhe nuk ishin vetëm te majtë !Kam dëgjuar në një emision gazetarin e njohur dhe më vonë deputet i Demokracisë së Re , Pano Panajotopullo , kur deklaronte ,se në vitet studenteske dhe më vonë ndiqte , bile dhe diskutonte me miqtë e tij ato që dëgjonte në Radio Tirana.

“Prandaj, tregoi duke buzëqeshur, -shokët më thërisin : o Panos , o kokinos !(Panoja i kuq).Jota kishte një zë të mrekullueshëm , të qartë ,që gurgullonte si ujvarë !E dhe unë e kam ndjekur këtë emision që i vogël !Shumë fjalë greke , sidomos të sferës politike, nuk i kuptonim , por ne femijet na tërhiqte radioja !Nje radio e cuditshme , jo vetem në formë , jo vetëm per faktin , se pranë tij qëndronte një fener që jepte dritë , dhe nga ky fener radioja furnizohej me korent , pasi Goli , punonjësi i sallës së leximit , kështu i thoshim vates së kulturës në vitet e mia të feminisë, me një si pompë e furnizonte fenerin me vajguri !Ky fener dhe gramafoni gjigand, që i mbyllur, ngjante me nje makinë qepëse prej mobiljeNë ato vite në fund të emisionit transmetoheshin këngë të minoritetit . Spikeria ishte shume e kujdesshme në punën e saj! Nuk harronte që ishte e huaj dhe në një post delikat ,siç ishte Radioja, nje mjet i fuqishem propagande për regjimin. I vinin me qindra letra nga vendi i saj, letra te cilat ishin te mbushura me fjale falenderimi., me kerkesa per rubrika te reja dhe lajme e komente për fusha të ndryshme të jetës shqiptare të asaj kohe ! Ne shume prej letrave gjente dhrahmi ,te cilat i dorezonte ne zyren perkatese.Ajo ndiente shume emocione gjate emisionit! E dinte, qe ne Atdheun e vet e degjonin shume kete emision .Ishte vertet domethënëse, t'u drejtohej bashkeatdhetareve te taj, ne



Nga Petro MEJDI

gjuhen.e perbashket nga nje shtet tjetër !

Qe kur iku nga Greqia ,me 1938 ajo , nuk e pa kurre Greqine dhe njerezit e saj !Emrin e Jotes (Panajota) e kam ndeshur ne dy botime , “Ju flet Tirana “te Agron Çobanit dhe “Historia e Radiotelevizionit Shqiptar “te Skifter Këllicit .Ajo u largua nga Shqiperia, u riatdhesua ne vitin 1988 !Fliste me shume mall per Shqiperine dhe me shume respekt per shqiptaret !

Nga koha e intervistes kane kaluar mbi 13 vjet !A eshte ne jete Jota Ikonomu !? Nuk e dime !Por dime nje gje: shteti shqiptar i demokracise, duhet te mos e harronte Joten ., kete spikere , e cila zbriti ne Pire çupë e vogel dhe me pas ishte e detyruar qe me zerin e saj brilant, të përcillte propagande partiake, të cilën, ndoshta , edhe vetë nuk e besonte!., Ajo duhej (ndoshta duhet) te merrte nje dallim mirenjohjeje nga ky shtet , te cilit i sherbeu ! Kane kaluar gati 40 vjet qe atehere , por “Sas millun ta Tirana “ (Ju flet Tirana !) ne hapje te emisionit dhe “Edho radhiofonikos stathmos Tiranon !Ja hara !” ne mbyllje te tij (Ketu radio Tirana !Mireupafshim!) me jehojne ende në veshët e mi !///

Ujëvara e Peshturës si një destinacion turistik në Kurvelesh



Nga Nikolla LENA, (1)

TEPELENE. Krahina e Kurveleshit është zonë malore, e ndërtuar kryesisht nga shkëmbinj gëlqerorë të kretakut e pjesërisht nga flishi, me relief të lartë e të ashpër në pjesën më të madhe të tij, që në Kurveleshin e Sipërm merr karakterin e një rrafshnalte shumë të copëtuar nga përrenjtë me shtretër të thellë e gryka të ngushta në trajtë kanionesh deri 150 m. të thella, rrëpirash e humnerash si në Nivicë, Lekdush etj. Janë të përhapura shumë dukuritë dhe format karstike si: gropa, puse, galeri, shpella si dhe mjaft fusha karstike si ajo e Progonatit, e Golemit etj., ku janë përqendruar edhe qendrat kryesore të banimit dhe tokat bujqësore.

Ujërat e shirave e të borës së shumtë, nëpërmjet hinkave, puseve e të çarave të tjera karstike, depërtojnë shpejt në thellësi të tokës. Kjo bën që, sidomos Kurveleshi i Sipërm, të ketë burime të kufizuara uji. Më e pasur është zona barishtore me kullota të shumta, ku gjenden shumë bimë mjekësore, mjaltesa e aromatike çaji, salepi, trëndelina etj., duke e bërë Kurveleshin një vend të përshtatshëm për zhvillimin e blegtorisë, sidomos asaj të imët deles e dhisë.

Kurveleshi i Sipërm, në pikëpamje natyrore, është një kështjellë nga ku, për të dalë në qendër të tij, në Gusmar, mund të futesh vetëm nëpër disa drejtime e kryesisht grykash malore si Gryka e Bënçës, Gryka e Vërmikut, Gryka e Borshit për në Kuç e Grykë të Shurit deri në Gusmar dhe Gryka e Kaparielit, që të nxjerr në Golem-Gusmar apo edhe Qafa e Kreshtës.

Ky pozicion gjeostrategjik e shkëput disi Kurveleshin, sidomos atë të Sipërm, nga krahinat e tjera dhe ka favorizuar qëndresën e armatosur të kurveleshasve, por edhe ruajtjen e vlerave etnokulturore autoktone.

Sot, kjo zonë është future në projekte të shumta turistike që nisin nga bregdeti I Jonit dhe ngjiten drejt zonës malore. Turistët e parë eksploratorë të natyrës, historisë dhe aventurës, kanë filluar të udhëtojnë drejt këtyre zonave me bukuri të rrallë mjedisore. Monumentet e natyrës si maja malesh, shkëmbinj, drurë apo ujvara, janë kthyer në destinacione të mirfillta turistike që shfrytëzohen nga agjenci të shumta të turizmit lëvizës.///

1 Gazetar, ATSH (Agjensia Telegrafike Shqipatre)



1. Per here te pare ne bregdetin e Ksamilit promovohet tabele sinjalistike dygjuheshe kushtuar vlerave ekoturistik te kate Ishujve joniane te Ksamilit.

Tabela u realizua nga **Agjencia AJMMI** me mbeshtetjen e **REC Shqiperi** ne kuader te programit **ACHIEVE** te **BE**



Cast para Tabeles sinjalistike. (nga e majta ne te djathte: Sh. Hajno, Sh. Ahmeti, M. Kallojeri, Gj. Mano, K. Kauri)

2. Agjencia AJMMI i dhuroi se fundi nje numer pemesh dekorative shkolles 9-vjecare te Cukes, institucion arsimor qe menaxhohet nga drejtuesja e pasionuar Violeta Shehu. Kontributi i AJMMI-t u mundesua ne kuader te nismave mjedisore qe ka perqafuar kjo shkolle ne rajonin e Sarandes .



AJMMI dhuron peme dekorative per shkollet e Cukes

Shembull qe duhet ndjekur.



Gjithekush e njeh ne Sarande ate djal me trup mesatar, me floke te verdhe e fytyre te rreshkur nga dielli i jugut. Bashkeqytetaret e tij por edhe vizitoret vendas e te huaj, e kane te fiksuar vendin ku qendron perhere ai. Me nje kitare ne dore, ulur ne sofatin e rruges qe zbret nga shkallaret drejt Plazhit

te Ri, djaloshi me mrin Tomorr Kapo i mirepret mysafiret me tinguj e kitares. Por ndjeshmeria e tij qytetare shkon edhe me teper se kaq. Pesë muaj me pare u bë deshmitar i nje akidenti gati tragjik , kur nje bashkeqytetar i tij. Ahmet. H.. u rrezua duke ngjitur shkallet e shumta për te dalë ne rrugë. I dha ndihmët mjekësore ne spital dhe ne ate cast i lindi idea te montonte mbajtese prej hekuri ne gjithe gjatesinë e shkallareve qe bashkojne rrugen “Mitat Hoxha” me Plazhin e Ri dhe shkallaret ne drejtim te rruges” Ismail Qemali”. Me embelsine e fjales se tij, arriti te grumbulloje rreth 50 mije leke te reja nga biznesmenet per rreth. dhe

per pak kohe realizoi ngritjen e 30 e ca metra kangjela mbështetëse prej hekuri te cilat edhe i lyeu me boje anti ndryshk. Sfida e tij por edhe e atyre qe e mbeshteten kete nisme qytetarie, synon te vazhdojne edhe me tej , permes shkallareve karakteristike te Sarandes. Ky investim qytetar vlerësohet me dobi per te moshuarit , vendas apo turiste te huaj qe hyjne nga Portit detar e rte vizituar qytetin bregdetar. Edhe te semurt por edhe te vegjelit mund te mbeshteten ne keto kangjella, per te lehtesuar ngjitjen apo zbritjen nga rruga ne rruge.

Sofokli Mekshi. AJMMI Sarande

Rehabilitim i Ishujve jonianë në një dokumentar. - Krim dhe mosndeshkim!-




Nga Etleva XHAJANKA

ATSH - Etleva XHAJANKA// Këto ditë, Agjencia AJMMI (Joniane Joniane e Mjedisit, Medias dhe Informacionit) në Sarandë, perfundoi punën për realizimin e një dokumentari me titull “Rehabilitim ne Ishujt e dëmtuar të Ksamilit. Krim dhe mosndëshkim”. Burime të kësaj orgaizate mjedisore të shoqërisë civile bënë të ditur për ATSH-në se “Prej një periudhe 6 mujore, stafi I AJMMI-t, së bashku me punëtorë, specialistë dhe vullnetarë mjedisore pas nderhyrjeve rehabilituese te dy ishujve te demtuar te Ksamilit; permes sensibilizimit te publikut të gjerë per ruajtjen nga demtimet te Ishujve realizoi dokumentarin ”Sipas drejtorit ekzekutiv të AJMMI-t , Shkëlqim Hajno, - Ky projekt dhe vet dokumentari sensibilizues, nuk do të realizohej dot pa mbeshtetjen e REC-Shqiperi në kuadër të programit ACHIEVE të financuar nga Komisioni European ne Tirane Per rreth 30 minuta, shikuesit e zakonshem por edhe njerzit e interesuar per mjedisin,

ndjekin me kersheri, ne menyre kronologjike, nje rezyme te gjithe punes se kryer qe nga hartimi I projektit, nenshkrimi I Memorandumit te bashkepunimit me aktore e faktore te interesuar e pergjegjes , pregatitja e transporti I bazes materiale deri ne ishull ,etj,. Shikuesit njihen me operacionet e nderhyrjes teknike per krijimin e gardhinave dhe mbjelljen e bimesise autoktone te ishujve te Ksamilit.

Ne te shkuaren komuniste, vizitat dhe pushimi ne keta ishuj, ishte privilegj I hierarkise te larte te partise- shtet. Vetem pas viteve 90 keto mjedise iu kthyen qytetareve vendas e te huaj. Fatkeqesisht, me pas dy nga kater ishujt u bene

pre e lakmise se disa bizneseve, te cilet demtuan n je pejs ete habitatit eutokton. Dokumentari terheq edhe vemendjen e strukturave ligjzbatuese per ruajtjen ne vazhdimesi te vlerave te reja te ishujve , pervecse nxit komunitetin e banoreve e te vullnetareve mjedisore ne shkolla e biznese, per te mbrojtur floren , faunen dhe gjithe mjedisin ne keta ishuj; per t'i kthyer ata ne atraksion turistik per pushues vendas e te huaj, gjate gjithe vitit. Pritet qe dokumentari mbi ishujt e Ksamilit e promovohet ne shkollen e Ksamilit, qendren kulturore “Dea” dhe disa shkolla te Sarandes.///



I ÇMENDURI

Nga Chalil Gibran



Më pyete : Si u çmenda?
Ja se si: Një agim, shumë kohë para se të lindnin perënditë e panumërta, u zgjova nga një gjumë i thellë dhe pashe se me kishin vjedhur të gjitha maskat e mia .Të shtatë maskat që

unë vetë, i kisha krijuar dhe që i kisha veshur në shtatë jetët e mia. Vrapova atëhere fytyrëzbuluar nëpër rrugët plot njerëz duke britur: "Hajdutët, hajdutët!Hajdutë të mallkuar !"

Shumë burra dhe gra me tallnin dhe te tjerë , vrapun të trembur drejt shtëpive te tyre. Sa arrita ne treg, nje djalosh sipër nje strehe bërtiste:

-'Një i cmendur!.

Ngrita kokën t'a shikoj. Atëhere, për herë të parë, dielli uthi fytyrën time te zhveshur dhe shpirti im u mbush plot dashuri për diellin. Dhe, që nga ai moment nuk i doja perseri maskat e mia. Dhe si ne ekstaze bërtita:

- Të bekuar, të bekuar janë ata që vodhën maskat e mia!

Keshtu u çmenda. Dhe në

marëzinë time i gjeta te dyja: Lirinë dhe sigurinë. Lirinë e vetmisë dhe sigurinë që askush nuk më kupton. Sepse ata që na kuptojnë, na skllavërojnë diçka.... Por, le mos të jem dhe kaq krenar për sigurinë time.

Akoma dhe një hajdut, edhe në qoftë se është i burgo-sur, ka rreth tij dhe ruhet nga një tjetër hajdute.


Kush nuk di dhe nuk e di qe nuk di, është i cmendur, shmangiu. Kush nuk di dhe e di qe nuk di, është femije, me-soje. Kush di dhe nuk e di qe e di, është duke fjetur, zgjoje. Kush di dhe e di qe di, është sofist(i ditur), shko pas tij.....

Gibran

Me tha zoti:- "dashuro armikun tend" dhe une dashurova veten.....Gibran



(Perktheu: Vasilika IFANDI)



Poezi nga Qazim SHEMAJ

PEGASI IM..

Mez axhami,
sa me vrull e more!
Trokoje, fluturoje, hingellije
dhe kujtove se te gjithë njerezit
kishin syte vetem te ti.
Po bota ka pune te tjera:
tregtaret -fitimet,
nepunesit-karrierat!....
E sheh, budallai im, ç'të gjeti?!
Te pranishmit e shurdher u bene
te verber,
shikuesit e verber u bene te shurdher
dhe vajte, u lodhe, mbete...
Po hajde, hidhu, arrakati im,
s'dremitet keshtu ne mes te udhes!

SONTE JAM

NJE KALE I PLAGOSUR

Mos me mbingarkoni me keshilla!
Asgje nuk mbaj me dot mbi vete.
Sonte jam nje kale i plagosur,
kam vetem etje,
Nje zhan me shpifes te shtrine, miku im.
I mora dhembjet e tua me vete...
Oh, jam i plagosur, nje kale i plagosur,
Kam vetem etje.

PORTRET I PAMBARUAR

Vajti e blerta e syve te mi.
Tani syte e mi kane ngjyren e barit
te thare te gushtit.
Ku ta gjej ate djaloshin flokeverdhe
(veten time te ri?)

Ku vane zjarret?! Kane mbetur vetem
thinjat e hirta te prushit.
Me lodhen, biri im, me idhuj dhe rruge
te kota;
me shpifje me shkrehen, me varferi
Poet i madh s'u bera dot
Dhe vajti. iku endrra ime.
Tani nuk kam me asnje hall.
Vrasesit e mi jane ende gjalle.
As qe dua te hakmerrem dhe ne hesap s'i kam
po bota si molle prej veseve krimbet!
O zot, sa njeri i zymte jam:
kendoj qe te mos qaj nga dhimbjet.
Eh, dhimbjet, vete i vura ne gjume
i perkunda
dhe harrova te rritem keshtu, u munda.
Tani ato s'mbahen me,
s'i genjej dot me perralla,
me nina-nana
ulkonja te uritura ulerijne
dhe qiellit me thonj ia gerryejne kambanen.
...Me fal gruaja ime, te paskam vrare
dhe si Akili mbi trupin e bukur
te Pentesileas
derdh lote.
S'te bera dot zonje,
asnje pale veth s'te bleva dot.
Dhe skillav kam qene, dhe kaproll i hutuar
ne dhele, ne dhembje, ne muzg e ne merzi.
cdo çast te jetes kam luftuar
ta sundoj boten me dashuri.
Eh, zonjeza ime dashuri,
askush me mire se une
sekretet e tua s'i di.
Prej teje kam lindur e rilindur sa here
dhe pyll, dhe lume dhe det i gjere.
Pa ty kam vdekur, kam ikur, jam zhdukur.
Te lutem, zonje, o zonja ime,
bëmë perseri me te bukur!



AGJENCIA JONIANE
E MJEDISIT, MEDIAS,
INFORMACIONIT

“REHABILITIM I GJELBËR I ISHUVJE JONIANË”

Ksamil, Krim dhe mosndëshkim!

*Një Film Dokumentar nga AJMMI
ME MBESHTETJEN E REC Shqiperi &
Programi ACHIEVE - European union IN Albania*



Skenari & Regjia : **Shkëlqim HAJNO**
Montazhi & Narrator: **Viktor AVDIA**
Konsulent: **Kristo KAURI**
Koordinator: **Sofokli MEKSHI**

